



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 98 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2023

VENDIM

Nr. 28, datë 07.02.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.02.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të Masterplanit për projektin “*Landscaping and entry to Apollonia Archeological Park*”, Brenda Kufirit Park Arkeologjik, me aplikues Genti Çupi dhe zhvillues Bashkia Fier dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
2. Përmbajtja e të gjitha tabelave, dizenjimi, pozicionimi dhe materialet e tyre duhet të paraqiten pranë KKTKM për shqyrtim dhe Vendimmarrje;
3. Nyjet higjeno-sanitare të lëvizshme dhe Porta Hyrëse të ritrajtohen nga ana arkitektonike dhe të unifikohen estetikisht me objektet e tjera të propozuara;
4. Të shikohet mundësia e aksesimeve alternative për në park, përveç hyrjes kryesore;
5. Gjatë hartimit të Projekt Idesë, të rishikohet monitorimi dhe mundësia e kontrollit të itinerarit të turistëve;
6. Për të gjitha ndërhyrjet brenda në park, Projekt Idea duhet të plotësohet me specifikimet dhe materialet e përdorura për të gjitha ndërhyrjet që propozohen brenda parkut;
7. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2, nga NJAKPA dhe DSHA;
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
9. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
10. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Eugen KALLFANI

